
Reagim kundër ndryshimit të nenit 437 të Kodit Penal nga Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë (MD), së fundmi ka propozuar amendamentimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkritazi nenin 437, i cili rregullon çështjen e mos raportimit ose raportimit të rremë të pasurisë, të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose të detyrimeve financiare, nga zyrtarët e lartë publik. Neni 437,¹ në mënyrë shumë të qartë rregullon penalizimin e refuzimit të deklarimit dhe deklarimin e rrejshëm të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik.

Organizata Çohu!, Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Lëvizja Fol, shprehen kundër ndryshimeve/ndërrhyrjeve në nenin 437, të Kodit Penal ashtu siç janë propozuar nga MD.

Propozimi i ardhur nga MD, dhe i aprovuar nga Qeveria e Kosovës, po synon vendosjen e **motivit** përkritazi me fshehjen e pasurisë nga zyrtarët e lartë publik. Ky ndryshim në Kodin Penal, do ta bëjë të pamundur akuzimin e aq më pak dënimin e zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e deklarojnë (fshehin), pasurinë komfor kërkesave të Ligjit për Deklarim të Pasurisë.

Amendamenti i Kodit Penal, i propozuar nga MD, në thelb është i pakuptimtë dhe si i tillë tregon për tendencën e qeverisë për ta reduktuar transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të lartë publik. Kjo për arsye se gjyqtarët në praktikë do ta kenë shumë të vështirë për ta vërtetuar motivin për mos deklarim apo fshehje të pasurive duke qenë se zyrtarët, në këto raste, gjithmonë do të mund të arsyetohen se këtë veprim nuk e kanë bërë më qëllim, apo që edhe kanë harruar që ta deklarojnë një pjesë të pasurive të tyre.

Në këtë kuadër, MD me këtë propozim-amendament më shumë do t'i kontribuojë amnistimit të zyrtarëve që mund të jenë pasuruar në mënyrë të kundërligjshme se sa do të vendosë rregull efektiv në këtë fushë.

¹ Neni 437, Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare:

1. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.
2. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. Vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet.

Kodifikimi i këtyre dy veprave penale në Kod Penal, është shumë i qartë dhe nuk lejon aspak hapësirë të keqinterpretimit. Vepra penale (mos-deklarimi apo refuzimi i deklarimit), konsiderohet se kryhet në momentin kur zyrtari nuk e deklaron, apo deklaron rrejtshëm (fshehtë) pasurinë në kohën e paraparë me ligj (1-31 mars), dhe nëse nuk deklarohen të dhëna që parashihen me dispozitat ligjore për t'u deklaruar, atëherë konsiderohet se është kryer vepra penale e raportimit të rrejtshëm të pasurisë.

Arsyet që janë përdorur nga ministri i drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, për ta justifikuar këtë vendim të qeverisë, nuk kanë bazë faktike. Kjo duke qenë se problemet që janë shfaqur me disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, përkitazi me deklarimin jo të plotë të pasurisë mund të rregullohen dhe të mënjanoen nga Agjencia Kundër Korrupsion.

Vendimi për ta penalizuar 'refuzimin për deklarim', si dhe 'deklarimin e rrejtshëm', të pasurisë në përgjithësi, është njëri ndër përparimet më esenciale në legjislacionin kundër korrupsion. Si rezultat direkt i penalizimit të 'refuzimit për ta deklaruar' pasurinë, nga zyrtarët e lartë publik, numri i atyre që dështojnë për të përmbushur këtë obligim ligjor ka rënë dukshëm. Më 2012, kur refuzimi për të deklaruar pasurinë nga zyrtarët e lartë publik nuk ka qenë vepër penale, numri i atyre që nuk e kishin deklaruar pasurinë ishte 216, përderisa më 2013 dhe 2014, numri ka rënë substancialisht në 35, përkatësisht në 2 zyrtarë që refuzuan ta deklarojnë pasurinë.

Sipas të dhënave zyrtare nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, vetëm gjatë vitit 2014, kanë qenë në punë rreth 181 lëndë që kanë të bëjnë me nenin 437 të Kodit Penal të Kosovës, mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë. Prej tyre, 28 janë shqyrtuar dhe 153 kanë mbetur për vitin 2015. Nga 28 lëndët që janë zgjidhur gjatë vitit 2014, që kanë të bëjnë me nenin 437 (mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë), 9 lëndë janë parashkruar (7 në Mitrovicë, 1 në Prishtinë dhe 1 në Podujevë).

Ministria e Drejtësisë, dhe qeveria duhet të shqetësohen për këtë fenomen, dhe duhet të përpiqen për hartimin e normave të reja që do të mundësonin verifikimin e saktësisë së të dhënave të deklaruara dhe kontrollin e origjinës së pasurisë, përfshirë këtu edhe zgjerimin e kompetencave të AKK-së për verifikimin dhe kontrollimin e pasurive, që zyrtarët e lartë i kanë jashtë vendit.

*Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU!
Institutit Demokratik i Kosovës - KDI
Lëvizja Fol
www.cohu.org
www.levizjafol.org
www.kdi-kosova.org*